



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:205344

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05722791

C.nr.3478/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesional L.K. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit B.K. me numër personal nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 482.83 euro, jashtë seance, me datë 22.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.K. nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësi të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.10.2019 – 31.12. 2019, në shumën prej 32.80 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 22.04.2020, në shumën prej 3.02 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 35.82 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (06.10.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, në shumë prej 446.51 euro, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Mamushës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi B.K. nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 06.10.2022, përmes të autorizuarit të tij av. A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditësi është punëtor i arsimit pranë SHFMU “Anadollu” në Mamushë, dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 15.11.2022, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka bërë precizimin e padisë, duke theksuar se paditësi ka pagën bazë në shumën prej 405.00 euro dhe i takon e drejta në kompensim sipas inflacionit nga data 01.08.2019 deri me datën 30.06.2022, në shumë të përgjithshme prej 428.83 euro dhe atë, për vitin 2019 - $405 \times 2.7\% = 10.93$ euro për muaj $\times 5 = 54.65$ euro, për vitin 2020- $405 \times 0.2\% = 0.81$ euro për muaj $\times 12$ muaj $= 9.72$ euro, për vitin 2021 - $405 \times 3.4\% = 13.77$ euro për muaj $\times 12$ muaj $= 165.24$ euro dhe për vitin 2022 - $405 \times 11.6\% = 42.12$ euro për muaj $\times 6$ muaj $= 252.72$ euro.

E paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 14.12.2022, ku ka theksuar se paditësi ka dal në pension në bazë të vendimit për njohjen e pensionimit me datë 22.04.2020, i njëjti pa kurrfarë baze ligjore ka bërë llogaritjen e normës së inflacionit nga data 01.08.2019 deri me datën 20.06.2022, në shumën e përgjithshme monetare prej 501.57 euro andaj ky fakt nuk mund të jetë i pranueshëm pasi që paditësi nuk e ka vërtetuar me asnjë provë të besueshme, por kjo është vetëm një supozim nga i njëjti. Ka shtuar se padia është e pakuptueshme dhe e njëjta nuk bazohet me asnjë provë të vetme dhe bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, andaj nga kjo del se paditësit me anë të padisë ka kërkuar përmbushjen e një detyrimi që tash është parashkruar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim edhe me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut, ndërsa Kontrata Kolektive si e tillë nuk është nënshkruar nga Komuna e Mamushës por kjo është nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata – MASHT, andaj si e tillë Komuna e Mamushës nuk ka të ndarë vijën buxhetore për pagesën e beneficioneve të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta hudhë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399

të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës nr. protokollit 020/2016 për paditësin e lëshuar nga Komuna e Mamushës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Anadolu” në Mamushë, si arsimtarë i teknologjisë -TIK, që nga data 01.09.2005 – e deri me datë 22.04.2020 kur edhe është pensionuar. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.10.2019 - 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, mirëpo me precizimin e kërkesëpadisë është kërkuar shuma prej 405.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 32.80 euro ($405 * 2.7\% = 10.93 * 3 = 32.80$)
- Për periudhën 01.01.2020-22.04.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, mirëpo me precizimin e kërkesëpadisë është kërkuar shuma prej 405.00

euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 2.43 euro ($405 * 0.2\% = 0.81 * 3 = 2.43$), si dhe periudha 2 ditë të muajit Prill është 0.59 euro, sipas ($0.81/30 = 0.027 * 22 = 0.59$) = $2.43 + 0.59 = 3.02$ euro. Apo në shumë të përgjithshme prej 35.82 euro duke e llogaritur për periudhën 01 Tetor 2019 deri 22 Prill 2020 ($32.80 + 3.02 = 35.82$).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, pasi që vlerësoi se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit B.K. në emër të kompensimit të inflacionit në pagë, t’ia paguaj shumën në lartësi prej 35.82 euro, duke llogaritur pagën bazë në lartësi prej 405.00 euro, kjo duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata, vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitën ligjore 399 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, ku rezultoi se kërkesëpadia e paditësit Behaydin Koka përtej shumës së aprovuar në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, deri në shumën e përgjithshme të kërkuar, në lartësi prej 482.33 euro, në emër të kompensimit të inflacionit në pagë refuzohet si e pa bazuar pasi që nga Vendimi nr.10 të datës 23.03.2020, të lëshuar nga Komuna e Mamushës, paditësit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 22.04.2020, për shkak të arritjes moshës së pensionimit, andaj kërkesa për kompensim në emër të përqindjes së inflacionit për periudhën pas kësaj datë refuzohet e pa bazuar.

Gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 06.10.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.08.2019 deri më datë 01.10.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 2 muaj apo në shumën prej 21.00 euro, ndërsa paditësi e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 06.10.2022, në bazë të lartcekurave.

Gjykata vendosi të i'a llogaris pagën e paditësit aq sa është kërkuar me precizimin e kërkesëpadisë në shumën prej 405.00 euro dhe jo bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019, 2020, 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e

pagës bazë e paditësit, e që është shuma prej 421.00 euro sepse gjykata në bazë të nenit 2 par. 1 të LPK-së, është e kufizuar të veproj brenda kufijve të kërkesave të ndërgjyqësve.

Rrjedhimisht shuma e përgjithshme e refuzuar në lartësi prej 446.51 euro është për periudhën 01.08.2019 deri më 01.10.2019 si kërkesë e parashkruar në lartësi prej 21.00 euro, si dhe prej periudhës 22.04.2020 deri më 30.06.2022 në lartësi prej 425.51 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (06.10.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3478/2022, datë 22.05.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.